



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:022650

Datë: 08.02.2024

Numri i dokumentit: 05304833

KP.nr.155/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen juridike të paditësit “Ceni Com” Sh.p.k me numër të biznesit 810258500 me seli në fshatin Zhegër – Komuna Gjilan të cilin sipas autorizimit e përfaqëson A.H. nga Gjilani kundër të paditurës M.SH. në cilësinë e pronarit të “MS Finance” L.L.C me NRB 81075648 me seli në Fshatin Kmetoc – Komuna Gjilan, me objekt kontesti vërtetimi i pronësisë, vlera e kontestit 5.000,00 Euro, jashtë seance më datën 07.02.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET e tërhequr padia e paditësit “Ceni Com” Sh.p.k me numër të biznesit 810258500 e ushtuar më datën 14.02.2020 kundër të paditurit paditurës M.SH. në cilësinë e pronarit të “MS Finance” L.L.C me NRB 81075648, për vërtetimin e pronësisë.

A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarit E.N., në Gjykatën Themelore në Gjilan më datën 14.02.2020 ka ushtuar padi kundër të paditurit M.SH. në cilësinë e pronarit të “MS Finance” L.L.C me NRB 81075648, për vërtetimin e pronësisë.

Kjo lëndë është transferuar në Gjykatën Komerciale të Kosovës sipas vendimit me numër 347/22 të datës 28.07.2022 të KGJK-së për transferimin e lëndëve në Gjykatën Komerciale.

Gjykata me Aktvendim të datës 19.10.2023 paditësit i ka kthyer në plotësim padinë, duke e obliguar që në afate prej 3 ditësh nga dita e pranimit të vendimit ta plotësoj padinë me adresën e saktë të palës së paditure, konform dispozitës së nenit 99 lidhur me nenin 102 të LPK-së, duke e njoftuar të njëjtën edhe për pasoja ligjore në raste të mos veprimit sipas këtij Aktvendimi.

Meqenëse paditësi në afatin e caktuar nga gjykata nuk e ka bërë plotësimin e padisë, sipas Aktvendimit të pranuar më datën 16.11.2023, Gjykata konform nenit 102 par. 3, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) në të cilin përcaktohet se *“Do të konsiderohet se është tërhequr parashtrësia po që se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar, e në qoftë se i kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, parashtrësia do të hidhet poshtë”*, vendosi që padinë e paditësit ta konsideroj të tërhequr.

Nga të lartcekurat Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi konform nenit 102 par.3 të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm

KP.nr.155/22 me datë 07.02.2024

Gjyqtari
Gent Bekeri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimin të aktvendimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2020:022650
Datë: 08.02.2024
Numri i dokumentit: 05304833